

RELACION

PËR

PROJEKVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

‘PËR

MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2026-2030”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030” propozohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin dhe koordinimin e politikave në fushën e mbrojtjes sociale, si një dokument strategjik ndërsektorial i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 synon përmirësimin e mirëqenies dhe cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me parimet dhe standardet e përcaktuara në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe në Strategjinë e Bashkimit Evropian për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2030.

Qëllimi themelor i projektaktit është garantimi i respektimit të dinjitetit njerëzor, barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe siguri i aksesit të barabartë në shërbime publike, arsim gjithëpërfshirës, punësim dhe formim profesional, strehim social, shërbime shëndetësore cilësore, pjesëmarrje në jetën politike dhe publike, si dhe jetesë të pavarur dhe përfshirje të plotë në komunitet. Plani synon gjithashtu: (i) mënjanimin e barrierave fizike, sociale dhe institucionale; (ii) forcimin e koordinimit ndërinstitutional; (iii) garantimin e pjesëmarrjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.

Hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030 mbështetet në vlerësimin e prioriteteve kombëtare dhe në gjetjet e dy raporteve afatmesme të monitorimit të planit pararendës, duke reflektuar nevojën për përmirësim të mëtejshëm të kuadrit ligjor, institucional dhe të ofrimit të shërbimeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti për miratimin e Planit Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 është në përputhje me Programin e Qeverisë - Shqipëria 2030”, me Shtyllën III, “Mirëqenie për të gjithë”. Ai përbën një dokument politik në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Dokumentit të Politikave për Përfshirjen Sociale, si dhe është pjesë e programit analitik të projektakteve ligjore dhe nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2026.

Plani është i harmonizuar me dokumentet strategjike kombëtare dhe sektoriale, ndër të cilat: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030; Plani Kombëtar i Veprimit për Integrim Evropian; Dokumenti i Politikave Prioritare 2026–2028; Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025; Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2021–2026; Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030; Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030; Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030; Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” 2022–2026; Strategjia për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030; Strategjia për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030; Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale 2024–2028; Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030; Plani Kombëtar i Veprimit LGBTI+ 2021–2027, si dhe dokumente të tjera përkatëse.

Plani është në përputhje me Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, në veçanti OQZH 1, 2, 3, 4, 5, 8, 10 dhe 16.

Në kuadër të procesit të integritimit evropian, është në linjë me Strategjinë e BE-së për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2030, me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale (Parimi 17) dhe me Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore (Neni 26).

Raporti i Progresit i Bashkimit Evropian për Shqipërinë 2025 evidenton se korniza ligjore dhe institucionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mbetet e paplotë dhe zbatimi i saj kërkon përmirësim të mëtejshëm; legjislacioni është vetëm pjesërisht në përputhje me Konventën e OKB Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; Shqipëria nuk ka ratifikuar Protokollin Opsional të saj; progresi në deinstitutionalizim dhe ofrimin e shërbimeve është i kufizuar; ndërsa cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht me dëmtime

dëgjimi, paraqet shqetësim. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030 adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë këto gjetje.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë e projektaktit lidhen me konsolidimin e përpjekjeve ligjore dhe institucionale në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 108/2012 për ratifikimin e Konventës së OKB-së, me synim transformimin e shoqërisë përmes heqjes së barrierave mjedisore dhe informuese. Projektakti parashikon objektiva dhe aktivitete konkrete, të mbështetura financiarisht nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët, si dhe identifikon hendekun financiar për periudhën 2026–2030, duke mundësuar planifikim më të qëndrueshëm të burimeve. Fushat prioritare të ndërhyrjes – aksesueshmëria; drejtësia dhe barazia para ligjit; punësimi dhe aftësimi; arsimi; mbrojtja sociale; shërbimet shëndetësore; përfshirja dhe pjesëmarrja në jetën politike dhe publike; si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional – sigurojnë një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse. Plani mbështetet në gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2021–2025 dhe përmban indikatorë të matshëm, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke forcuar transparencën, monitorimin dhe llogaridhënien.

Problematikat që synohen të adresohen lidhen me: (i) ekzistencën e barrierave mjedisore dhe të informacionit të paaksesueshëm, të cilat pengojnë integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara; (ii) nevojën për forcimin e harmonizimit dhe koordinimit ndërinstitucional në fushat kyçe të jetës shoqërore dhe publike; (iii) nivelin e pamjaftueshëm të aksesit në drejtësi, shërbime sociale, shëndetësore dhe arsimore për grupet me nevoja të veçanta; si dhe (iv) nevojën për planifikim të qëndrueshëm të burimeve financiare për periudhën 2026–2030.

Efektet e pritshme nga miratimi i projektaktit janë:

- Përmirësim të përfshirjes sociale dhe integritit të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e jetës. Rritje e aksesueshmërisë fizike dhe informative në nivel kombëtar.
- Konsolidim të mekanizmave të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional.
- Përmirësim të monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve përmes indikatorëve të matshëm dhe bazuar në standarde evropiane.
- Rritje e transparencës, llogaridhënies dhe planifikimit strategjik për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara në periudhën 2026–2030.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030 është në linjë me objektivat e Strategjisë së BE-së për Personat me Aftësi të Kufizuara (soft *acquis*) dhe referon një sërë direktivash të Bashkimit Evropian, përfshirë: Direktivat 2000/43/EC dhe 2000/78/EC; Direktiva 2014/24/BE; Direktiva 2016/2102; Direktiva (BE) 2018/1972; Direktiva 2014/53/BE; Direktiva (BE) 2019/882; si dhe Direktiva (BE) 2024/2841 për themelimin e Kartës Evropiane të Aftësisë së Kufizuar dhe Kartës Evropiane të Parkimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Projektakti është i parashikuar në PKIE, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe përafron kuadrin strategjik të BE.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030” miraton një dokument strategjik ndërsektorial, i cili strukturohet në tetë fusha prioritare, të organizuara në objektiva specifike, masa prioritare dhe ndërhyrje konkrete për periudhën 2026–2030.

Plani ka si qëllim strategjik realizimin progresiv të aksesueshmërisë universale në mjedise fizike, shërbime publike dhe private, transport, informacion dhe komunikim, duke përfshirë edhe ambientet e trashëgimisë kulturore dhe sektorin e turizmit. Në këtë kuadër, parashikohen masa për eliminimin e pengesave arkitektonike, përmirësimin e standardeve të ndërtimit, garantimin e aksesit në teknologji ndihmëse dhe rritjen e aksesueshmërisë digjitale në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian.

Një tjetër shtyllë thelbësore e planit është garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë dhe barazia para ligjit për të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, parashikohen masa për përshtatjen e procedurave gjyqësore dhe administrative, ofrimin e asistencës ligjore të aksesueshme, si dhe

forcimin e kapaciteteve të institucioneve për të garantuar trajtim të barabartë dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Në fushën e punësimit dhe aftësimit profesional, plani synon rritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, nxitjen e punësimit të denjë dhe krijimin e mundësive të barabarta për zhvillim profesional. Parashikohen masa për përmirësimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në punë, promovimin e punësimit gjithëpërfshirës, mbështetjen e sipërmarrjes, si dhe forcimin e programeve të aftësimit profesional në përputhje me nevojat e tregut.

Në sektorin e arsimit, plani synon sigurimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet, si dhe promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin përmirësimin e infrastrukturës arsimore, rritjen e kapaciteteve të personelit mësimor, sigurimin e mjeteve didaktike të përshtatura dhe garantimin e mbështetjes individuale për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara.

Në fushën e mbrojtjes sociale, plani synon përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes shërbimeve dhe përfitimeve të aksesueshme, të përbalueshme financiarisht dhe të orientuara drejt nevojave të individit. Parashikohen masa për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve komunitare, për mbështetjen e jetesës së pavarur dhe për përparimin e procesit të deinstitutionalizimit.

Në sektorin e shëndetësisë, plani synon garantimin e kujdesit shëndetësor të aksesueshëm dhe të përbalueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë përmirësimin e aksesit në shërbime rehabilituese, pajisje ndihmëse dhe teknologji mbështetëse.

Një fushë e veçantë i kushtohet përfshirjes dhe pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike, përfshirë garantimin e së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, pjesëmarrjen në aktivitete kulturore dhe sportive, si dhe përfaqësimin në struktura vendimmarrëse. Planit parashikon gjithashtu masa për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, përmirësimin e mekanizmave të koordinimit dhe konsolidimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet nisur nga fusha e përgjyeshme përkatëse.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektati i propozuar është përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me asistencë teknike nga PNUD. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2026- 2030 në Republikën e Shqipërisë është hartuar përmes një procesi ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga ministrinë e linjës, institucionet shtetërore, organizatat e/për personat me aftësi të kufizuar) dhe partnerët strategjikë.

Projektakti do të dërgohet për mendime në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Shtetit dhe Kryenegociatorin, Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Institutin e Statistikave, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Agjencinë Kombëtare të Sigurisë së Informacionit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Universitetin Politeknik të Tiranës, Shkollën e Magjistraturës, Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës Shtetërore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja totale e përlogaritur për zbatimin e masave administrative të kësaj strategjie dhe të planit të veprimit është 7,615,080,707 (Shtatë miliardë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë milionë e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatë.) lekë.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030 shoqërohet me një analizë të detajuar financiare dhe me matrica të kostuara për secilën masë dhe aktivitet të parashikuar.

Për periudhën 2026–2030, parashikohet që 79% e financimit të nevojshëm për zbatimin e planit të mbulohet nga buxheti i shtetit; 2 % nga donatorët dhe burime të tjera; ndërsa 19% përbën hendek financiar, i cili do të kërkojë mobilizim të mëtejshëm të burimeve.

Procesi i kostimit është mbështetur në konsultime me institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave dhe në analizën e dokumenteve kombëtare, veçanërisht Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028. Matrica financiare përmban parashikimet e buxhetit për të gjitha aktivitetet e planit gjatë periudhës 2026–2030, si dhe shpërndarjen e burimeve sipas fushave prioritare.

Plani parashikon mekanizma për monitorimin e shpenzimeve dhe për vlerësimin periodik të realizimit të objektivave, me qëllim garantimin e përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike.

MINISTËR

Evis SALA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSMINISTËR

Eugena TOMINI